



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.49

29 prill

2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.6957 datë 30.3.2011	Për lejim lënieje të shtetësisë shqiptare.....	2067
Dekret nr.6983 datë 20.4.2011	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	2068
Vendim i KM nr.160, datë 2.3.2011	Për përcaktimin e masës së financimit, në buxhetin e vitit 2011, për bashkësitë fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave.....	2068
Vendim i KM nr.189, datë 9.3.2011	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të katit të parë, të vilës 2-katëshe, në rrugën “Xhorxh W. Bush”, nga Instituti i Integritimit të të Përndjekurve Politikë tek Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.....	2070
Vendim i KM nr.221, datë 23.3.2011	Për miratimin e marrëveshjes së financimit dhe projektit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave e Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, e KFW Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Zhvillimi i masterplanit të furnizimit me ujë dhe kanalizime në Shqipëri”.....	2072
Vendim i KM nr.222, datë 23.3.2011	Për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale dhe taksimetra, te njësitë e qeverisjes vendore.....	2072
Vendim i KM nr.226, datë 23.3.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.66, datë 7.2.2011 të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Brendshme, për blerje pajisjesh, mjetesh dhe materialeve speciale, në plotësim të nevojave të Policisë së Shtetit dhe të Gardës së Republikës”.....	2073

Vendim i KM nr.227, datë 23.3.2011	Për një shtesë në vendimin nr.175, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që transferohen në pronësi të komunës Horë-Vranisht të qarkut të Vlorës”.....	2073
Vendim i KM nr.229, datë 23.3.2011	Për shfuqizimin e vendimit nr.504, datë 13.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e përgjegjësive së administrimit të ish-spitalit të KFOR-it, Durrës, nga Ministria e Drejtësisë te Ministria e Shëndetësisë, për trajtimin e personave me masë mjekësore “Mjekim i detyruar në një institut mjekësor”.....	2074
Vendim i KM nr.232, datë 23.3.2011	Për miratimin e funksioneve të strukturave përgjegjëse në sektorin mineral të Republikës së Shqipërisë.....	2075
Vendim i KM nr.233, datë 23.3.2011	Për miratimin e formës së raporteve, të mënyrës së botimit të të dhënave për pagesat e taksave vendore dhe kombëtare në sektorin mineral të Republikës së Shqipërisë, si dhe të nivelit të konfidencialitetit në kuadër të nismës për transparencë në industrinë nxjerrëse.....	2079
Vendim i KM nr.234, datë 23.3.2011	Për krijimin e Universitetit të Arteve.....	2083
Vendim i KM nr.235, datë 23.3.2011	Për kalimin në pronësi, të bashkisë Sarandë, të sipërfaqes 9200 m ² , nga trualli funksional i pronës nr.206 “Rezidenca Qeveritare Sarandë”, për një ndryshim në vendimin nr.1058, datë 16.7.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për drejtorinë e shërbimeve qeveritare”, të ndryshuar, dhe për një ndryshim në vendimin nr.20, datë 9.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Sarandë të qarkut të Vlorës”.....	2084
Vendim i KM nr.240, datë 31.3.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.55, datë 26.1.2011 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2011, në njësitë e qeverisjes qendrore”.....	2087
Vendim i KM nr.242, datë 23.3.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.1282, datë 23.12.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kuotën e pranimit dhe tarifën e shkollimit në programet e ciklit të tretë të studimeve specializuese afatgjata, në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, për vitin akademik 2009-2010”, të ndryshuar.....	2088
Vendim i KM nr.246, datë 31.3.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.68, datë 28.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Bushat të qarkut të Shkodrës”.....	2089

Vendim i KM nr.247, datë 31.3.2011	Për disa ndryshime dhe një shtesë në vendimin nr.51, datë 26.1.2011 të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë fondi Komitetit Ndërministror të Emergjencave Civile, për përballimin e situatës emergjente të krijuar në qarkun e Shkodrës si pasojë e përmbytjeve natyrore”.....	2090
Vendim i KM nr.248, datë 31.3.2011	Për kalimin e sipërfaqes 4000 m ² , pronë shtetërore, në fondin e kompensimit fizik dhe kompensimin e Komunitetit Mysliman Shqiptar, Myftinia Korçë.....	2091
Vendim i KM nr.249, datë 31.3.2011	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.....	2093
Vendim i KM nr.250, datë 31.3.2011	Për propozimin, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të kandidaturave alternative për anëtar të Komisionit të Shërbimit Civil..	2093
Vendim i KM nr.251, datë 31.3.2011	Për lirimimin dhe emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Dibrës.....	2094
Vendim i KM nr.252, datë 9.2.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.793, datë 24.9.2010 të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin e ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë””.....	2094
Vendim i KM nr.253, datë 31.3.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.574, datë 28.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Fier të qarkut të Fierit”.....	2098
Vendim i KM nr.254, datë 6.4.2011	Për disa shtesa në vendimin nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të ministrave të linjës”, të ndryshuar.....	2098
Vendim i KM nr.255, datë 2.4.2011	Për shpallje ditë zije kombëtare.....	2099
Vendim i KM nr.293, datë 14.4.2011	Për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale dhe taksimetra për 7 komuna dhe 3 bashki.....	2099
Udhëzim i MASH nr.14, datë 28.3.2011	Për njohjen e testimeve dhe certifikimeve për gjuhën angleze për programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë.....	2100
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Nazmi Gazidedja.....	2102

DEKRET
Nr.6957, datë 30.3.2011

PËR LEJIM LËNIEJE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Adelina Demir Luznaku (Lika)
2. Adrian Hamdi Shkëmbi
3. Agim Shyqyri Ballvora
4. Albert Rexhep Pazari
5. Altin Lami Rrapi
6. Angela Niko Sulaj
7. Anila Shaqir Jeworowski (Koçi)
8. Ardit Maliq Gjika
9. Artan Skënder Banushaj
10. Artur Besnik Krasniqi
11. Aurora Perikli Çipa
12. Besnik Behar Bonaj
13. Denisa Fatmir Struga
14. Detar Qamil Lajthia
15. Enida Kristaq Mitro
16. Erald Sihat Muço
17. Ester Enver Cara
18. Guljed Emin Birçe
19. Manda Ramazan Seli
20. Melissa Niko Sulaj
21. Migena Bajram Zagonjulli
22. Minella Dhimitër Leni
23. Mira Tajfun Hasanbelli
24. Niko Reuf Sulaj
25. Pullumb Gani Kaciqi
26. Renato Luan Hafizllari
27. Rovena Kastriot Sulaj (Salataj)
28. Shaban Skënder Çekrezi
29. Sherete Rustem Pazari
30. Suela Bedri Zwinger (Bushati)
31. Suela Petrit Weiper (Bajraktari)
32. Urim Mehmet Islami

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.6983, datë 20.4.2011

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, të Kushtetutës, të nenit 9, pika 7, nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij personit të mëposhtëm:
Gazmend Milazim Saiti

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
BAMIR TOPI

VENDIM
Nr.160, datë 2.3.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË FINANCIMIT, NË BUXHETIN E VITIT 2011, PËR
BASHKËSITË FETARE QË KANË NËNSHKRUAR MARRËVESHJE ME KËSHILLIN E
MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.10 140, datë 15.5.2009 “Për financimin nga Buxheti i Shtetit të bashkësive fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”, të nenit 5 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shuma prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh, e miratuar për financimin e bashkësive fetare, në buxhetin e vitit 2011, të përdoret sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, e sipas ndarjes së mëposhtme:

a) Komuniteti Mysliman i Shqipërisë përfiton shumën 31 632 000 (tridhjetë e një milionë e gjashtëqind e tridhjetë e dy mijë) lekë, të ndarë, si më poshtë vijon:

i. 16 758 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë mijë) lekë, për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore për punonjësit e administratës;

ii. 10 374 000 (dhjetë milionë e treqind e shtatëdhjetë e katër mijë) lekë, për financimin, për pagat e arsimtarëve të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar;

iii. 4 500 000 (katër milionë e pesëqind mijë) lekë për ndërtimin e për mirëmbajtjen e objekteve të kultit, në Bajram Curri, Tropojë, Shupenzë, Çermë, Roshnik etj.

b) Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë përfiton shumën 26 220 000 (njëzet e gjashtë milionë e dyqind e njëzet mijë) lekë, të ndarë, si më poshtë vijon:

i. 21 660 000 (njëzet e një milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore për punonjësit e administratës;

ii. 4 560 000 (katër milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë për financimin për pagat e arsimtarëve të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

c) Kisha Katolike në Shqipëri përfiton shumën 25 878 000 (njëzet e pesë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë, të ndarë, si më poshtë vijon:

i. 4 332 000 (katër milionë e treqind e tridhjetë e dy mijë) lekë për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore, për punonjësit e administratës;

ii. 21 546 000 (njëzet e një milionë e pesëqind e dyzet e gjashtë mijë) lekë për financimin për pagat e arsimtarëve të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

ç) Kryegjyshata Botërore Bektashiane përfiton shumën 16 270 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e dyqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, të ndarë, si më poshtë vijon:

i. 3 762 000 (tre milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë) lekë për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore për punonjësit e administratës;

ii. 8 508 000 (tetë milionë e pesëqind e tetë mijë) lekë për ndërtimin e për mirëmbajtjen e objekteve të kultit “Odeoni”;

iii. 4 000 000 (katër milionë) lekë, për shkak të pozitës së veçantë, si Kryegjyshitë Botërore me qendër në Tiranë, dhe të shtrirjes së veprimtarisë së saj jashtë vendit.

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Financave dhe Komiteti Shtetëror për Kultet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

I. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë me shumën 31,632,000 lekësh të ndarë si më poshtë:

1. Mbështetje për fondin e pagave të personelit në shumën 16,758,000 lekë për 147 punonjës.

2. Mbështetje për pagat e arsimtarëve në shumën 10,374,000 lekë për 91 arsimtarë.

3. Për rikonstrukcion dhe mirëmbajtjen e objekteve të kultit në shumën 4,500,000 lekë për objektet e mëposhtme:

i) Xhamia e Bajram Currit 3,960,000 lekë

ii) Xhamia Shupenzë 540,000 lekë

II. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë me shumën 26,220,000 lekë, të ndarë si më poshtë:

1. Mbështetje për fondin e pagave të personelit në shumën 21,660,000 lekë për 190 punonjës.

2. Mbështetje për pagat e arsimtarëve në shumën 4,560,000 lekë për 40 arsimtarë.

III. Kisha katolike me shumën prej 25,878,000 lekë, të ndarë si më poshtë:

1. Mbështetje për fondin e pagave të personelit në shumën 4,332,000 lekë për 38 punonjës.

2. Mbështetje për pagat e arsimtarëve në shumën 21,546,000 lekë për 189 arsimtarë.

IV. Kryegjyshata Botërore Bektashiane me shumën 16,270,000 lekë, të ndarë si më poshtë:

1. Mbështetje për fondin e pagave të personelit në shumën 3,762,000 lekë për 33 punonjës.

2. Për rikonstrukcion e mirëmbajtje të objekteve të kultit në shumën 8,508,000 lekë për objektin “Odeon”.

3. Për Kryegjyshitën Botërore si kryeqendër, për veprimtari ndërkombëtare, në shumën 4,000,000 lekë, të ndarë si më poshtë:

i) Veprimtaria ndërkombëtare në shumën prej 2,000,000 lekësh.

a) veprimtaria për 20-vjetorin e rihapjes së Kryegjyshitës Botërore Bektashiane dhe 80-vjetori i vendosjes së saj në Shqipëri, e cila do të mbahet në Tiranë në mars 2011, me shumën 1,451,000 lekë;

b) veprimtaria për pjesëmarrje në pelegrinazhin e Haxhi Bektashit, Turqi, me shumën 549,000 lekë.

ii) Për udhëtime e pritje të Kryegjyshitës Botërore në gjyshatat dhe institucionet bektashiane që ndodhen në vende të tjera, si: SHBA, Maqedoni, Kosovë, Turqi, Egjipt, Bullgari, Greqi, Hungari, Francë etj., shumën 2,000,000 lekë.

VENDIM
Nr.189, datë 9.3.2011

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË MJEDISEVE TË KATIT TË PARË, TË VILËS 2-KATËSHE, NË RRUGËN “XHORXH W. BUSH”, NGA INSTITUTI I INTEGRIMIT TË TË PËRNDJEKURVE POLITIKË TEK INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të katit të parë, të vilës 2-katëshe, në rrugën “Xhorxh W. Bush”, nga Instituti i Integrimit të të Përndjekurve Politikë tek Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, sipas planimetrisë së dhënë në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Administrimi i kësaj prone të paluajtshme bëhet në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe në Kodin Civil, duke mos ndryshuar destinacionin e saj.

3. Ngarkohen Instituti i Integrimit të të Përndjekurve Politikë, Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, si dhe Agjencia për Inventarizimin dhe Administrimin e Pronave të Paluajtshme të Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

c. Regazione d'ITALIA



~~FRATELLI PARE~~



PRIMO PIANO

Scala 1:100

VENDIM
Nr.221, datë 23.3.2011

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT DHE PROJEKTIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE E MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, E KFW, FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “ZHVILLIMI I MASTERPLANIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIME NË SHQIPËRI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së financimit dhe projektit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave e Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, dhe KfW, Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Zhvillimi i masterplanit të furnizimit me ujë dhe kanalizime në Shqipëri”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.222, datë 23.3.2011

PËR KOMPENSIMIN E VLERËS SË TAKSËS SË BIZNESIT TË VOGËL, TË PËRDORUR PËR RIMBURSIMIN E PAJISJEVE FISKALE DHE TAKSIMETRAVE, TE NJËSITË E QEVERISJES VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bashkisë Tiranë t’i shtohet fondi prej 96 494 030 (nëntëdhjetë e gjashtë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e tridhjetë) lekësh, për kryerjen e kompensimit të vlerës së taksës së biznesit të vogël, të cilën e ka përdorur për rimbursimin e vlerës së pajisjeve fiskale dhe taksimetrave.

2. Ky fond të përballohet nga fondi i kontigjencës i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.226, datë 23.3.2011

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.66, DATË 7.2.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E BRENDSHME, PËR BLERJE PAJISJESH, MJETESH DHE
MATERIALESH SPECIALE, NË PLOTËSIM TË NEVOJAVE TË POLICISË SË SHITETIT
DHE TË GARDËS SË REPUBLIKËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.66, datë 7.2.2011 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në titullin e vendimit fjalët “... dhe të Gardës së Republikës ...” shfuqizohen.

2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, në programin buxhetor “Policia e Shtetit”, t’i shtohet fondi prej 660 000 000 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë milionë) lekësh, për blerje pajisjesh, mjetesh, materialesh të tjera speciale, si dhe për sistemin e monitorimit me kamera të qytetit të Tiranës.

Nga ky fond, 634 650 700 (gjashtëqind e tridhjetë e katër milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e shtatëqind) lekë të klasifikohen, si shpenzime për investime, dhe 25 349 300 (njëzet e pesë milionë e treqind e dyzet e nëntë mijë e treqind) lekë, për mallra e shërbime.”.

3. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Fondi, prej 660 000 000 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë milionë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.227, datë 23.3.2011

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 175, DATË 13.2.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE
DHE KULLOTA, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË KOMUNËS HORË-VRANISHT
TË QARKUT TË VLORËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.175, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave, të shtohet edhe lista e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 11 (njëmbëdhjetë) fletë, që përfundon me numrin

rendor 402 (katërqind e dy), e që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Lista shitesë e pyjeve dhe kullotave, si dhe tabela me lidhjen numër 1 (një) i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe njësia e qeverisjes vendore Horë-Vranisht të qarkut të Vlorës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Njësia e qeverisjes vendore Horë-Vranisht

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
85-93,102-111,113-169	Pyje, kullota dhe sipërfaqe me bimësi pyjore	Pronësi
171-182,184-192,194		
199-202,207,212-213		
215-230,235-246,250-252		
255-256,259-265,269		
279-310,312-324,327-333		
337,339,342,347-373		
375-376,379,382,384-385		
387-389,391-441,445-480		
484-487,491-495,497,505		
507-524,526-541,543-560		
565-568,570-571,577-583		

VENDIM

Nr.229, datë 23.3.2011

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.504, DATË 13.5.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË ISH-SPITALIT TË KFOR-IT, DURRËS, NGA MINISTRIA E DREJTËSISË TE MINISTRIA E SHËNDETËSISË, PËR TRAJTIMIN E PERSONAVE ME MASË MJEKËSORE “MJEKIM I DETYRUAR NË NJË INSTITUT MJEKËSOR””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15 shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr.504, datë 13.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit të ish-Spitalit të KFOR-it, Durrës, nga Ministria e Drejtësisë të Ministria e Shëndetësisë, për trajtimin e personave me masë mjekësore “Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor””.

2. Ish-Spitali i KFOR-it, Durrës, kalon në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Shëndetësisë dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.232, datë 23.3.2011

**PËR MIRATIMIN E FUNKSIONEVE TË STRUKTURAVE PËRGJEGJËSE NË SEKTORIN
MINERAR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 30, 43 pika 6, e 56, pika 1 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 36/1 të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Strukturat përgjegjëse për dhënien e lejeve minerare, mbikëqyrjen dhe monitorimin e veprimtarive minerare në zbatim të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, janë:

a) Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN).

b) Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH).

c) Reparti i Inspektim-Shpëtimit të Minierave (RISHM).

ç) Drejtoria përkatëse në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës që trajton problemet e veprimtarisë minerare.

d) Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL).

2. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) ka këto detyra:

a) Hartimin e hartave për veprimtaritë minerare për shfrytëzimin e mineraleve të Republikës së Shqipërisë, pjesë e programit të veprimit 3-vjeçar të strategjisë minerare, dhe zonimin e planit vjetor minerar.

b) Hartimin e hartave të zonave të rrezikut minerar për zonat minerare të Republikës së Shqipërisë.

c) Pranimin, regjistrimin dhe publikimin në *web site* të datës e të orës së kërkesës për aktverifikimin e lejes së shfrytëzimit ose të lejes së kërkim-zbulim-shfrytëzimit për zonat e hapura.

ç) Shqyrtimin e miratimit të zonës së rrezikut minerar dhe të çdo kërkesë për të drejtë minerare gjatë miratimit të projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare;

d) Shqyrtimin e plotësimit të kushteve të dhënies së lejes së shfrytëzimit dhe dokumenteve vërtetuese për kërkesat për zonat e hapura dhe fituesit e procedurës së konkurrimit publik, të renditura më poshtë:

i) realizon aktin e verifikimit të lejeve të shfrytëzimit;

ii) realizon aktin e verifikimit të lejeve të kërkim-zbulim-shfrytëzimit;

iii) vlerëson projektin e zhvillimit të veprimtarive minerare të shfrytëzimit dhe bën oponencën e tij;

iv) vlerëson projektin e rehabilitimit të zonës minerare që përfshin, projektin e veprimtarive të mbylljes, projektin e menaxhimit të mbetjeve minerare, projektin e rehabilitimit progresiv e minerar të zonës minerare;

v) vlerëson vlerat e garancive financiare për realizimin e programit të investimit dhe realizimin e planit të rehabilitimit të zonës minerare dhe përgatit aktin e miratimit të ministrit për këto garanci;

vi) bën oponencën dhe harton vendimin e këshillit teknik, që nënshkruhet nga titullari i institucionit dhe sekretari, e cila duhet të përmbajë miratimin ose mosmiratimin për projektin e zhvillimit të veprimtarive minerare dhe planit të rehabilitimit, si dhe vlerat e garancive financiare për realizimin e programit të investimit dhe realizimin e planit të rehabilitimit të zonës minerare dhe e dërgon atë në METE brenda afateve kohore të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

dh) Mbikëqyrjen për respektimin nga titullari i lejes së kushteve së lejes dhe të normave të detyrueshme të legjislacionit në fuqi për veprimtarinë minerare.

e) Raportimin për kontrollin e zbatimit të këtij ligji për lejet minerare të shfrytëzimit.

ë) Mbështetjen e ministrit për përgatitjen e politikave e të programeve në fushën minerare për:

i) drejtimet për zhvillimin e sektorit minerar;
ii) promovimin e zonave minerare, për të cilat do të jepen lejet minerare të shfrytëzimit, përmes procesit të konkurrencës apo procedurave të hapura;
iii) promovimin e zonave minerare për shfrytëzim, mbështetur në hartën minerare digjitale, e cila hartohet brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe përditësohet vazhdimisht;
iv) parashikimin e përgjithshëm të produktit vjetor në sektorin minerar;
v) programimin e veprimtarive të shfrytëzimit të mineraleve;
vi) nevojat për zhvillimin e burimeve njerëzore, profesionale në veprimtaritë minerare;
vii) rregullat për mbrojtjen e mjedisit, peizazhit dhe rehabilitimin e tij;
viii) tabelën me vlerat minimale të sipërfaqes së zonës së lejuar të lejeve minerare të shfrytëzimit sipas grupimeve të mineraleve, vlerën minimale të investimit për lejet minerare të shfrytëzimit, si dhe vlerat minimale të prodhimit të mineralit, për zonat konkurruese dhe zonat e hapura, sipas grupeve të mineraleve.

f) Monitorimin minerar e postminerar të minierave të mbyllura dhe në regjim konservimi.

g) Mbikëqyrjen dhe monitorimin e depozitimeve të mbetjeve minerare të minierave në veprimtari shfrytëzimi, të braktisura, të mbyllura dhe në regjim konservimi.

gj) Shqyrtimin e planeve vjetore të veprimtarisë minerare të shfrytëzimit për çdo leje minerare.

h) Hartimin dhe paraqitjen ministrit, çdo 3 (tre) muaj, të një raporti, i cili përmban të dhëna për:

i) realizimin e prodhimit;
ii) realizimin e investimeve;
iii) vlerën e produkteve të shitura;
iv) vlerën e punimeve minerare të realizuara;
v) vlerën e operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare.

i) Hartimin dhe paraqitje ministrit, çdo 6 (gjashtë) muaj, të një raporti për çdo veprimtari minerare shfrytëzimi, i cili përmban të dhëna për:

i) respektimin e realizimit të projektit minerar;
ii) realizimin e operacioneve e të punimeve minerare dhe depozitimimin e mbetjeve minerare;
iii) lëvizjen e rezervave minerare;
iv) kryerjen e operacioneve minerare në përputhje me normat e ruajtjes së mjedisit minerar, duke u këshilluar me autoritetet e qeverisjes vendore të zonës minerare.

j) Propozimin ministrit për masat e penaltetit që duhet të ndërmerren ndaj subjekteve minerare që nuk respektojnë kërkesat e legjislacionit minerar mbi bazën e rezultateve të mbikëqyrjes dhe të monitorimit të veprimtarive minerare.

3. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) ka të drejtë:

a) të kryejë inspektime për ndjekjen e respektimit të dispozitave të këtij ligji, të lërë detyra, të marrë masa administrative apo të propozojë marrjen e tyre nga ministri, si pezullimin e punimeve të veprimtarisë minerare deri në ndalimin e veprimtarisë minerare dhe heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit;

b) të kërkojë informacion nga zotëruesi i lejes sa herë vlerëson se ai përdor praktika të dëmshme shfrytëzimi të mineraleve dhe të trajtimit të tyre, për respektimin e standardeve mjedisore të pranuar sipas legjislacionit në fuqi, apo se ai i drejton operacionet e punës në kundërshtim me ato të parashikuara në projektin e miratuar, si dhe çdo të dhënë tjetër, për të llogaritur detyrimet financiare, që ka zotëruesi sipas këtij ligji.

4. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) ka këto detyra:

a) Hartimin e hartave të veprimtarive minerare për kërkim-zbulimin e mineraleve në Republikën e Shqipërisë, pjesë e programit të veprimit 3-vjeçar të strategjisë minerare, dhe zonimin e planit vjetor minerar.

b) Pranimin, regjistrimin dhe publikimin në *web site* të datës dhe orës së kërkesës për aktverifikimin e lejes së kërkim-zbulimit për zonat e hapura.

c) Shqyrtimin e plotësimit të kushteve të dhënies së lejes së kërkim-zbulimit për kërkesat për zonat e hapura dhe fituesit e procedurës së konkurrimit publik, si më poshtë vijon:

i) realizon aktin e verifikimit për lejet e kërkim-zbulimit;

ii) vlerëson projektin e zhvillimit të veprimtarive minerare të kërkim-zbulimit dhe programin minimal të punës për kërkim-zbulimin dhe bën oponencën e tij;

iii) vlerëson projektin e rehabilitimit të zonës minerare, që përfshin projektin e veprimtarive të mbylljes, projektin e menaxhimit të mbetjeve minerare, projektin e rehabilitimit progresiv e minerar të zonës minerare;

iv) vlerëson vlerat e garancive financiare për realizimin e programit minimal të punës për lejet e kërkim-zbulimit dhe realizimin e planit të rehabilitimit të zonës minerare dhe përgatit aktin e miratimit të ministrit për këto garanci;

v) bën oponencën dhe harton vendimin e këshillit teknik, që nënshkruhet nga titullari i institucionit dhe sekretari, që duhet të përmbajë miratimin ose mosmiratimin për projektin e zhvillimit të veprimtarive minerare e të planit të rehabilitimit, si dhe vlerat e garancive financiare për realizimin e programit minimal të punës për lejet e kërkim-zbulimit dhe realizimin e planit të rehabilitimit të zonës minerare.

ç) Mbikëqyrjen e respektimit nga titullari i lejes të kushteve të lejes së kërkim-zbulimit dhe të normave të detyrueshme të legjislacionit në fuqi për veprimtarinë minerare.

d) Raportimin për kontrollin e zbatimit të këtij ligji për lejet minerare të kërkim-zbulimit.

dh) Mbështetjen e ministrit për përgatitjen e politikave e të programeve në fushën minerare për:

i) drejtimet për zhvillimin e sektorit minerar;

ii) promovimin e zonave minerare, për të cilat do të jepen lejet minerare të kërkim-zbulimit, përmes procesit të konkurrimit apo procedurave të hapura;

iii) promovimin e zonave minerare për kërkim-zbulim, mbështetur në hartën minerare digjitale, e cila hartohet brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe përditësohet vazhdimisht;

iv) programimin e veprimtarive të kërkimeve themelore gjeologjike;

v) nevojat për zhvillimin e burimeve njerëzore, profesionale në veprimtaritë minerare;

vi) rregullat për mbrojtjen e mjedisit, peizazhit dhe rehabilitimin e tij;

vii) tabelën me vlerat minimale të sipërfaqes së zonës së lejuar të lejeve minerare të kërkim-zbulimit, vlerën minimale të investimit për lejet minerare të kërkim-zbulimit sipas grupeve të mineraleve.

e) Shqyrtimin e planeve vjetore të veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit.

ë) Hartimin dhe paraqitjen ministrit, çdo 3 (tre) muaj, të një raporti, i cili përmban të dhëna për:

i) realizimin e investimeve;

ii) vlerën e punimeve minerare të kërkim-zbulimit të realizuara;

iii) vlerën e operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare;

f) Hartimin dhe paraqitjen ministrit, çdo 6 (gjashtë) muaj, të një raporti për çdo veprimtari minerare kërkim-zbulimi, i cili përmban të dhëna për:

i) respektimin e realizimit të projektit minerar;

ii) realizimin e operacioneve e të punimeve minerare dhe depozitimin e mbetjeve minerare

(nëse ka);

iii) vlerësimin e rezervave minerare të zbuluara;

iv) kryerjen e operacioneve minerare në përputhje me normat e ruajtjes së mjedisit minerar, duke u këshilluar me autoritetet e qeverisjes vendore të zonës minerare.

5. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) ka të drejtë:

a) të kryejë inspektime për ndjekjen e respektimit të dispozitave të këtij ligji, të lërë detyra, të marrë masa administrative apo të propozojë marrjen e tyre nga ministri, si pezullimin e punimeve

të veprimtarisë minerare deri në ndalimin e veprimtarisë minerare, heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit;

b) të kërkojë informacion nga zotëruesi i lejes sa herë vlerëson që ai përdor praktika të dëmshme të kërkim-zbulimit të mineraleve, për respektimin e standardeve mjedisore të pranuar sipas legjislacionit në fuqi, apo se ai i drejton operacionet e punës në kundërshtim me ato të parashikuara në projektin e miratuar, si dhe çdo të dhënë tjetër, për të llogaritur detyrimet financiare, që ka zotëruesi sipas këtij ligji.

6. Reparti i Inspektim-Shpëtimit të Minierave (RISHM) ka këto detyra:

a) Bashkëpunimin me institucionin e AKBN-së për hartimin e hartave të zonave të rrezikut minerar për zonat minerare të Republikës së Shqipërisë.

b) Kontrollin e respektimit nga titullari i lejes të kushteve të lejes dhe të normave të detyrueshme të sigurisë në punë e të mbrojtjes së shëndetit të punonjësve për veprimtaritë minerare sipas legjislacionit në fuqi për veprimtarinë minerare dhe atij të punës.

c) Mbështetjen e ministrit për përgatitjen e politikave e të programeve në fushën minerare për:

i) rregullat për zbatimin e masave për sigurinë në punë dhe sigurinë e punonjësve për veprimtaritë minerare;

ii) rregullat për mbrojtjen e mjedisit, peizazhit dhe rehabilitimin e tij.

ç) Respektimin e rregullave të sigurisë në vendet e depozitimeve të mbetjeve minerare në veprimtaritë minerare.

d) Hartimin dhe paraqitjen ministrit, çdo 6 (gjashtë) muaj, të një raporti për çdo veprimtari minerare kërkim-zbulimi, shfrytëzimi ose kërkim-zbulimi-shfrytëzimi, i cili përmban të dhëna për:

i) respektimin e kërkesave të sigurisë në veprimtaritë minerare, sigurisë në punë të punonjësve dhe rregullave për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve, duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse;

ii) respektimin e rregullave të sigurisë në vendet e depozitimeve të mbetjeve minerare.

7. Reparti i Inspektim-Shpëtimit të Minierave (RISHM) ka të drejtë:

a) të kryejë inspektime për ndjekjen e respektimit të dispozitave të këtij ligji, të lërë detyra, të marrë masa administrative apo të propozojë marrjen e tyre nga ministri, si pezullimin e punimeve të veprimtarisë minerare deri në ndalimin e veprimtarisë minerare, heqjen e licencave të përcaktuara me ligj ose me vendim të Këshillit të Ministrave për trajtim nga ky institucion;

b) të kërkojë informacion nga zotëruesi i lejes sa herë vlerëson se ai përdor praktika të dëmshme kërkim-zbulimi apo shfrytëzimi të mineraleve dhe të trajtimit të tyre, në kundërshtim me standardet dhe kërkesat e sigurisë në veprimtaritë minerare, sigurisë në punë të punonjësve dhe rregullave për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve, të parashikuara në projektin e miratuar dhe në përputhje me detyrimet që ka zotëruesi sipas këtij ligji.

8. Drejtoria përkatëse në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës që trajton problemet e veprimtarisë minerare ka këto detyra:

a) Mbështetjen e ministrit për përgatitjen e politikave e të programeve në fushën minerare për:

i) drejtimet për zhvillimin e sektorit minerar;

ii) hartimin e legjislacionit primar dhe atij sekondar për veprimtaritë minerare;

iii) hartimin e monitorimit e strategjive të zhvillimit të sektorit minerar;

iv) promovimin e zonave minerare, për të cilat do të jepen lejet minerare, përmes procesit të konkurrimit apo procedurave të hapura;

v) promovimin e zonave minerare, mbështetur në hartën minerare digjitale, e cila hartohet brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe përditësohet vazhdimisht;

vi) diskutimin e programit të zhvillimit të veprimtarive minerare e të planit vjetor minerar me institucionet e tjera.

b) Hartimin dhe paraqitjen ministrit, çdo 6 (gjashtë) muaj, të një raporti përmbledhës për veprimtarinë minerare në vend, bazuar në përmbajtjen e raporteve të tri strukturave: AKBN, SHGJSH, RISHM, i cili përmban të dhëna për:

i) ecurinë e veprimtarive minerare nëpërmjet plotësimit të indikatorëve vlerësues;

- ii) lëvizjen e rezervave minerare;
- iii) gjendjen e mjedisit minerar;
- iv) respektimin e standardeve të sigurisë në punë e të mbrojtjes së shëndetit të punonjësve;
- v) respektimin e rregullave të sigurisë në vendet e depozitimeve të mbetjeve minerare.
- c) Organizimin e konkurrimit publik për zonat konkurruese duke realizuar:
 - i) shpalljen e zonave minerare që kalojnë në konkurrim publik;
 - ii) vlerësimin e kriterëve teknike dhe financiare për subjektet konkurruese;
 - iii) shpalljen e fituesit për të drejtën e aplikimit të lejes minerare.

9. Drejtoria përkatëse në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, që trajton problemet e veprimtarisë minerare, ka të drejtë:

a) të kërkojë nga institucionet e AKBN-së, SHGJSH-së, RISHM-së të kryejnë inspektime për ndjekjen e respektimit të dispozitave ligjore, të lërë detyra për to për rastet kur ka ankesa, të bëjë vlerësime për moszbatim të ligjit, të marrë masa administrative apo të propozojë marrjen e tyre nga ministri;

b) të kërkojë nga institucionet e AKBN-së, SHGJSH-së, RISHM-së e QKL-së të respektojnë afatet procedurale për dhënien e të drejtave minerare për ndjekjen e respektimit të dispozitave të këtij ligji, të kërkojë përgjigje për rastet kur ka ankesa, vlerësime për moszbatim të ligjit;

c) të kërkojë informacion nga institucionet e AKBN-së, SHGJSH-së, RISHM-së e QKL-së, sa herë ka dyshime se prej tyre ka shkelje të rregullave të përcaktuara në këtë ligj.

10. Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) ka për detyrë:

a) pranimin e dokumentacionit të plotë për aplikimet e lejeve minerare në bazë të plotësisimit të kushteve, kriterëve dhe dokumentacionit përkatës të dhënies së lejes së kërkim-zbulimit, shfrytëzimit ose kërkim-zbulimit-shfrytëzimit në përputhje me kërkesat e ligjit minerar dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij për fituesit e konkurrimit publik për lejet minerare në zonat konkurruese dhe ato të aplikuesve për zonat e hapura.

b) vënien në dispozicion të institucioneve shqyrtuese, AKBN dhe SHGJSH, të dokumentacionit të plotë të aplikimit për leje minerare;

c) përcjelljen në mënyrë elektronike për procedurë miratimi ose refuzimi të dokumentacionit të paraqitur për vlerësim dhe oponencë në METE;

d) hartimin dhe paraqitjen ministrit, çdo 3 (tre) muaj, të një raporti për ecurinë e aplikimeve për leje minerare pranë këtij institucioni;

e) sigurimin e këshillimit për ministrin për përgatitjen e politikave e të akteve ligjore në fushën e lejeve/licencave.

11. Forma e funksionimit dhe organizimi i këtyre strukturave përcaktohen me ligj ose me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

12. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.233, datë 23.3.2011

PËR MIRATIMIN E FORMËS SË RAPORTEVE, TË MËNYRËS SË BOTIMIT TË TË DHËNAVE PËR PAGESAT E TAKSAVE VENDORE DHE KOMBËTARE NË SEKTORIN MINERAR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, SI DHE TË NIVELIT TË KONFIDENCIALITETIT NË KUADËR TË NISMËS PËR TRANSPARENCË NË INDUSTRIJË NXJERRËSE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 50 pika 5, 51 pika 3, e 56 pika 1 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të dhënat për pagesat e taksave vendore dhe kombëtare botohen e bëhen publike në kuadër të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse.

2. Shpërndarja e raporteve realizohet në përputhje me kërkesat e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI) dhe strategjinë e komunikimit të kësaj nisme.

3. Bërja publike e raportit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI) bëhet çdo 6 (gjashtë) muaj, në formë broshure, në faqen e internetit të ministrisë përgjegjëse për industrinë nxjerrëse dhe atë të Nismës për Transparencë për Industrinë Nxjerrëse dhe realizohet në përputhje me kërkesat e kësaj nisme.

4. Formulari i raportimit të të dhënave për pagesat e taksave vendore dhe kombëtare nga kompanitë minerare është i përcaktuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Formulari i raportimit të të dhënave për pagesat e taksave vendore dhe kombëtare nga institucionet shtetërore është i përcaktuar në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Raporti përmbledhës për zbatimin e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse duhet të përmbajë informacion në plotësim të kushteve të mëposhtme:

a) Përfshirjen e shoqërisë civile, të medias e të komuniteteve të rajoneve minerare në procesin e hartimit e të diskutimit të tij.

b) Përmirësimet ligjore për heqjen e pengesave për zbatimin e kësaj nisme.

c) Përfshirjen, në mënyrë progresive, të të gjitha kompanive që kryejnë veprimtari minerare.

ç) Garantimin që raportet e kompanive të jenë sipas standardeve ndërkombëtare dhe EITI-së.

d) Garantimin që raportet e institucioneve shtetërore të jenë sipas standardeve ndërkombëtare dhe EITI-së.

dh) Duhet të realizohet në përputhje me kërkesat e auditimit, të përcaktuara nga sekretariati i EITI-së dhe të marrë në konsideratë sugjerimet e këtij auditimi.

e) Duhet të përditësohet nga Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse.

7. Një ekspert i pavarur, i përzgjedhur në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe kërkesat e Sekretariatit Ndërkombëtar të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI), harton raportin përmbledhës për zbatimin e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse.

8. Raporti përmbledhës për zbatimin e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse miratohet nga grupi ndërinstytucional i punës i kësaj nisme, i krijuar me urdhrin nr.156, datë 27.12.2008 të Kryeministrit “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit ndërinstytucional të punës, për ndjekjen e procedurave të kandidimit të Shqipërisë në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI)”.

9. Raporti përmbledhës për zbatimin e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse diskutohet me shoqërinë civile, median dhe komunitetet e rajoneve minerare dhe reflekton opinionin e tyre në raportet pasardhëse.

10. Raporti përmbledhës për zbatimin e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse auditohet nga ekspertë të pavarur, të përzgjedhur sipas procedurave tenderuese në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe me kërkesat e sekretariatit të EITI-së.

11. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1

Forma e raportimit për NTIN (EITI)-Shqipëria			
A. Forma e raportimit nga kompanitë e industrisë minerare			
Vendi:		Kompania:	
NIPT: Kodi ekonomik i veprimtarisë:		Adresa: Tel: E-mail:	
Periudha e raportimit:		Viti:	
Informacione të detyrueshme	Referenca në bilancin e kompanisë	Volume	Vlera (në lekë)
Të ardhurat për shtetin (taksat) që paguhen nga kompanitë			
1a) Tatim fitimi			
1b) Renta minerare			
	- në lekë		
	- në natyrë		
1c) pagesa që lidhen me detyrimet e lejes minerare, pagesa të tjera të lidhura me procedurat e licencimit (specifikojë)			
1d) Bonuse të dhëna, bonuse për prodhim			
1e) Sigurimi i jetës			
1f) Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore			
1g) Pagesa të tjera për autoritetet lokale të specifikuar a) Taksë gjelbërimi b) Taksë tabele c) Taksë pastrimi d) Tatim pasurie			
1h) TAP (tatim mbi të ardhurat personale) a) Tatim i të ardhurave nga punësimi b) Tatime mbi të ardhurat e mbajtura në burim c) Tatimi mbi të ardhurat nga dividendët dhe aksionet			
1i) TVSH			
1j) Taksa doganore			

Të ardhura të tjera (informacion vullnetar)	Ref.	Volume	Vlera (në lekë)

Për nënshkrim nga nëpunësi përgjegjës i kompanisë së industrisë minerare

Ne njohim përgjegjësinë tonë se të dhënat e prezantuara në raportin e mësipërm janë në përputhje me të dhënat e regjistrave tanë me përjashtim të:

Emri _____ **Firma** _____ **Vula** _____
 _____;
Pozicioni _____ . **Datë**../.../20.....

ANEKSI 2

Forma e raportimit për NTIN (EITI)-Shqipëria			
A. Forma e raportimit nga institucionet shtetërore të taksave			
Vendi:		Kompania:	
NIPT: Kodi ekonomik i veprimtarisë:		Adresa: Tel: E-mail:	
Periudha e raportimit:		Viti:	
Informacione të detyrueshme		Referenca në bilancin e kompanisë	Volume
Të ardhurat për shtetin (taksat) që paguhen nga kompanitë			Vlera (në lekë)
1a) Tatim fitimi			
1b) Renta minerare			
		- në lekë	
		- në natyrë	
1c) pagesa për licencën dhe rinovimet, sipërfaqen e zonës minerare, pagesa të tjera të lidhura me procedurat e licencimit (specifikojë)			
1d) Bonuse të dhëna, bonuse për prodhimin			
1e) Sigurimi i jetës			
1f) Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore			
1g) Pagesa të tjera për autoritetet lokale të specifikuar			
a) Taksë gjelbërimi			
b) Taksë tabelle			
c) Taksë pastrimi			
d) Tatim pasurie			
1h) TAP (tatim mbi të ardhurat personale)			
a) Tatim i të ardhurave nga punësimi			
b) Tatime mbi të ardhurat e mbajtura në burim			
c) Tatimi mbi të ardhurat nga deidentët dhe aksionet			
1i) TVSH			
1j) Taksë doganore			

Të ardhura të tjera (informacion vullnetar)	Ref.	Volume	Vlera (në lekë)

Për nënshkrim nga nëpunësi përgjegjës i Institucionit Shtetëror të Taksave

Ne njohim përgjegjësinë tonë se të dhënat e prezantuara në raportin e mësipërm janë në përputhje me të dhënat e regjistrave tanë me përjashtim të:

Emri _____ **Firma** _____ **Vula** _____

_____ ; _____ ;

Pozicioni _____ . **Datë** ./.../20.....

VENDIM
Nr.234, datë 23.3.2011

PËR KRIJIMIN E UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 9, 10, 41, 76 e 77 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Krijimi dhe misioni i Universitetit të Arteve (UART):

1. Krijohet Universiteti i Arteve (UART), si institucion publik i arsimit të lartë, nëpërmjet riorganizimit të Akademisë së Arteve.

2. UART-ja ka për mision:

a) ofrimin e studimeve universitare të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë në fushën e artit e të kulturës;

b) zhvillimin e mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë artistike që kryhet brenda e jashtë vendit;

c) formimin e studiuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit të artit e të kulturës;

ç) thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushën e artit e të kulturës;

d) kryerjen e kërkimeve shkencore për të zhvilluar e tejçuar artin e kulturën;

dh) ndihmesën në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit dhe cilësisë së shoqërisë, si dhe përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë.

II. Struktura e UART-së:

1. Në strukturën e UART-së përfshihen njësitë kryesore, si më poshtë vijon:

a) Fakulteti i Muzikës, me këtë përbërje si njësi bazë:

i. Departamentin e kompozicion-muzikologji-dirigjimit;

ii. Departamentin e interpretimit.

b) Fakulteti i Artit Skenik, me këtë përbërje në njësi bazë:

i) Departamentin e aktrimit dhe regjisë së filmit dhe televizionit;

ii) Departamentin e regji-skenografi-koreografi-teori e arteve.

c) Fakulteti i Arteve të Bukura, me këtë përbërje në njësi bazë:

i) Departamentin e pikturës;

ii) Departamentin e skulpturës.

III. Programet e studimeve të UART-së

UART-ja ofron të gjitha programet e studimit në të tria ciklet e studimit që ka ofruar deri tani Akademia e Arteve dhe çdo program tjetër, të miratuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

IV. Organet dhe autoritetet drejtuese

1. Organet dhe autoritetet drejtuese të zgjedhura për strukturat e Akademisë së Arteve vazhdojnë mandatet e tyre.

2. Autoritetet drejtuese të UART-së janë:

a) Rektori;

b) Dekanët e fakulteteve;

c) Përgjegjësit e departamenteve.

3. Rektori emërohet sipas pikës 2 të nenit 23 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. Autoritetet drejtuese të zgjedhura të strukturave ekzistuese funksionojnë në përputhje me ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si edhe me statutin e UART-së.

5. Autoritetet e tjera drejtuese emërohen dhe funksionojnë në përputhje me nenin 23 të ligjit

nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

V. Organika dhe financimi

1. Organika e UART-së përmban numrin e punonjësve të njëjësive, që integrohen në të dhe që përfshihen në numrin total të punonjësve, që janë miratuar për Akademinë e Arteve.

2. Financimi i UART-së, për vitin 2011, bëhet nga:

a) buxheti i planifikuar për Akademinë e Arteve;

b) burime të tjera të ligjshme.

3. Universiteti i Arteve ruan të drejtën mbi të gjitha asetet dhe fondet buxhetore që zotëron dhe disponon ish-Akademia e Arteve.

4. Universiteti i Arteve ka selinë në Tiranë, në godinën e ish-Akademisë së Arteve.

5. Universiteti i Arteve e fillon veprimtarinë për vitin akademik 2011-2012.

VI. Dispozitat e vendimit nr.414, datë 12.11.1991 të Këshillit të Ministrave, ku përcaktohet krijimi i Akademisë së Arteve, shfuqizohen.

VII. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave dhe Universiteti i Arteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.235, datë 23.3.2011

PËR KALIMIN NË PRONËSI, TË BASHKISË SARANDË, TË SIPËRFAQES 9200 M², NGA TRUALLI FUNKSIONAL I PRONËS NR.206 “REZIDENCA QEVERTARE SARANDË”, PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1058, DATË 16.7.2008 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERTARE”, TË NDRYSHUAR, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.20, DATË 9.1.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË SARANDË TË QARKUT TË VLORËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, si dhe të neneve 3, 7, 8 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike, të shtetit, në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të bashkisë Sarandë, të qarkut të Vlorës, të sipërfaqes 9200 (nëntë mijë e dyqind) m² nga trualli funksional i pronës nr.206, me emërtim “Rezidenca qeveritare Sarandë”, sipas studimit pjesor urbanistik bashkëlidhur, i cili ndodhet në përgjegjësi administrimi të Këshillit të Ministrave, për ta përdorur për ndërtimin e një shkolle 9-vjeçare.

2. Në listën e pronave të paluajtshme publike, që i bashkëlidhet vendimit nr.1058, datë 16.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare”, të hiqet sipërfaqja prej 9200 (nëntë mijë e dyqind) m², nga prona nr.206.

3. Në listën paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Sarandë, të qarkut të Vlorës, që i bashkëlidhet vendimit nr.20, datë 9.1.2008 të Këshillit të Ministrave, të shtohet prona me nr.206/1, me sipërfaqe 9200 (nëntë mijë e dyqind) m².

4. Bashkia Sarandë ndalohet të ndryshojë destinacionin e sipërfaqes së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose ta japë në përdorim për të tretët.

5. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare detyrohet të bëjë kalimin në pronësi të kësaj sipërfaqeje, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Sarandë, dhe bashkia Sarandë për ndjekjen e procedurave të nevojshme për kalimin në pronësi të kësaj sipërfaqeje, në zbatim të këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLANIME I KIA E SHESHIT I E NDERTIMIT

OBJEKTI: SHKOLLE E RE 9 - VJECARE - SARANDE
 VENDNDODHJA: ZONA E RE "H, TURIZMI - K. CUKES" - SARANDE
 MIRATOHET ME VENDIM TE K.RR.T.R.SH.-96 NR. 3, DATE 19/02/1999
 MIRATOHET ME VENDIM TE KESHILLIT BASHKIAK NR. 6, DATE 30/01/2006

SHKALLA 1 : 1000




KONDIKSIONET URBANE
 SIPERFAQJA E PERGJITHESHME 5000.00 M2
 SIPERFAQJA E NDERTIMIT 1250.00 M2
 KOFICIENTI I SHFRYTEZIMIT 0.25
 NUMRI I KATEVE MBI TOKE 2 - 3 KATE
 NUMRI I KATEVE NEN TOKE 1 (NJJE)
 HYRJA NGA RRUGA KRYESORE
 MBULESA SOLETE BETON ARME

KUFIZIMET

VERIU RRUGE SHERBIMI
 JUGU BLOKU B1 ZONA H, TURIZMI - K. CUKES
 LINDJA BLOKU B1 ZONA H, TURIZMI - K. CUKES
 PERENDIMI RRUGA SIPAS STUDIMIT

MIRATOHET
 PER K. RR. T. E BASHKISE SARANDE
 KRYETARI
EDMOND GJOKA



SKEMA E VENDOSJES 1 : 2000

**INVESTITORI
 BASHKIA SARANDE**

DREJTORIA E URBANISTIKES	OBJEKTI	SHKOLLE E RE 9 - VJECARE - SARANDE
DREJTORI PANAJAR GJUNARI	EMERTIMI	ZONA E RE "H, TURIZMI - K. CUKES" - SARANDE
N. ARR.	URBANIST	PLANIMETRIA E SHESHIT TE NDERTIMIT
	PUNCI	VANGJEL TJUNI
	TOPOGRAF	VANGJEL TJUNI
	DATA	

VENDIM
Nr.240, datë 31.3.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.55, DATË 26.1.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË
PËRKOHSHME, PËR VITIN 2011, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 10 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.55, datë 26.1.2011 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2011, në njësitë e qeverisjes qendrore, është 1265 veta, sipas lidhjeve nr.1, nr.2 dhe nr.3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.”

b) Pas lidhjes nr.2, bashkëlidhur vendimit, shtohet lidhja nr.3 (me 95 punonjës shtesë), që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi të përballohen nga shpenzimet korente të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2011, të njëjësive të qeverisjes qendrore.

3. Ngarkohet Ministria e Financave të miratojë detajimin e numrit të punonjësve sipas lidhjes nr.3, brenda kriterëve të vendimit nr.1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministrinë dhe institucionet buxhetore”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e miratimit të tij.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.3

Gr.	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare	Muajt
04	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	10			
	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë	10	Specialistë	8 orë/ditë	6 muaj
14	Ministria e Drejtësisë	10			
	Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurisë	10	Specialistë	8 orë/ditë	6-mujore
29	Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor	4			
	Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor	1	Pastruese	4 orë/ditë	vjetore
	Gjykata e Apelit Tiranë	3	Sekretare gjyqësore	8 orë/ditë	6 muaj
	Total numri i punonjësve	24			

VENDIM
Nr.242, datë 23.3.2011

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1282, DATË 23.12.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUOTËN E PRANIMIT DHE TARIFËN E SHKOLLIMIT NË
PROGRAMET E CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE SPECIALIZUESE AFATGJATA,
NË FAKULTETIN E MJEKËSISË TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, PËR VITIN
AKADEMIK 2009-2010”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 pika 1.3.2, 34, 35 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1282, datë 23.12.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“1. Kuota e pranimit në programet e ciklit të tretë të studimeve specializuese afatgjata, në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, të jetë 446 e ndarë në specialitete, sipas shtojcës nr.1/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.
 2. Pika 2 shfuqizohet.
 3. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“4. Tarifa vjetore e shkollimit për studimet specializuese afatgjata në Fakultetin e Mjekësisë, të Universitetit të Tiranës, të jetë 40 000 (dyzet mijë) lekë për kandidatët fitues, që përfitojnë nga kuotat e pambuluara, dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë, për kandidatët fitues, që përfitojnë nga kuotat e planifikuara për Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Drejtësisë, si dhe nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë.”.
 4. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.
 5. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.
 6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCA NR.1/2
**KUOTAT E PRANIMIT NË STUDIMET SPECIALIZUESE AFATGJATA NË
FAKULTETIN E MJEKËSISË TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS**

Nr.	Programi i specializimit	Ministria e Shëndetësisë	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Drejtësisë	Trojet shqiptare	Kuota të pambuluara	Gjithsej
1	Alergologji	3	-	-	-	7	10
2	Anatomi patologjike	1	-	-	-	9	10
3	Anestezë reanimacion	12	-	-	-	8	20
4	Dermatologji	6	-	-	-	7	13
5	Endokrinologji	4	-	1	-	7	12
6	Gastrohepatologji	2	-	-	-	6	8
7	Hematologji	4	1	-	-	4	9
8	Diagnozë me imazhe	6	2	-	-	4	12
9	Kardiokirurgji	5	-	-	-	-	5

10	Kardiologji	5	-	2	1	10	18
11	Kirurgji e përgjithshme	10	2	-	-	8	20
12	Kirurgji maxilo-faciale	5	-	-	-	5	10
13	Lab.klinik-biokimik	2	1	-	-	10	13
14	Mikrobiologji	4	-	-	-	6	10
15	Mjek familje	9	-	-	-	26	35
16	Mjekësi interne	-	2	-	1	16	19
17	Mjekësi ligjore	-	-	-	-	5	5
18	Nefrologji	-	-	-	-	10	10
19	Neurologji	1	1	-	-	8	10
20	Neurokirurgji	5	2	-	-	2	9
21	ORL	2	-	1	-	4	7
22	Obstrikë gjinekologji	6	-	-	1Preshevë	12	19
23	Okulistikë	2	-	-	-	8	10
24	Onkologji	3	-	-	-	10	13
25	Ortopedi traumatologji	1	-	-	-	8	9
26	Pediatri	11	-	-	-	13	24
27	Pneumologji	-	1	-	-	11	12
28	Psikiatri	1	1	2	-	4	8
29	Psikiatri e fëmijëve dhe adoleshentëve	-	-	-	-	8	8
30	Rheumatologji	5	-	-	-	7	12
31	Sëmundje infektive	6	-	-	-	14	20
32	Shëndet publik	10	2	-	-	2	14
33	Terapi stomatologjike	2	-	-	-	13	15
34	Toksikologji klinike	-	-	-	-	5	5
35	Mjek urgjence	-	-	-	-	12	12
	Gjithsej	133	15	6	3	289	446

VENDIM
Nr.246, datë 31.3.2011

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.68, DATË 28.1.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS BUSHAT TË QARKUT TË SHKODRËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike, të shtetit, në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Bushat të qarkut të Shkodrës, i shtohen pronat me nr.517-2312 (pesëqind e shtatëmbëdhjetë-dymijë e treqind e dymbëdhjetë), gjithsej 145 (njëqind e dyzet e pesë) fletë, sipas lidhjes nr.2 dhe formularëve, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Në listën përfundimtare të inventarit, që i bashkëlidhet vendimit nr.68, datë 28.1.2008 të Këshillit të Ministrave, miratohen ndryshimet sipas listës që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, gjithsej 6 (gjashtë) fletë.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Bushat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
517-633	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproductive)	Në pronësi
634-689	Infrastrukturë (troje të lira)	Në përdorim
690-783, 831, 832	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim SAMT qarku Shkodër ka vënë në dispozicion të AKKP-së nga kjo komunë sipërfaqen prej 194 ha tokë bujqësore e shtrirë në 19 parcela dhe sipërfaqen prej 261.4 ha, tokë bujqësore e shtrirë në 20 parcela.
880-889	Infrastrukturë rrugë vendore	Në pronësi
928-931	Shërbime funerale (varreza)	Në pronësi
932	Prona që përdoren në fushën e kulturës dhe sportit.	Në pronësi
933-936,937,938,939-942, 943,944-1721,1792	Rrugë dhe kanale të treta	Në pronësi
784,785,785/1,786,787-830, 833-879	Kullotë	Në pronësi
1793-2312	Rrugë rurale dhe kanale të treta	Në pronësi
	Në listën e ndryshimeve, pasuria me nr.18, zona kadastrale 3205, lloji i pasurisë arë, sipërfaqja 81090 m ² , me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.400, datë 8.4.2008, i ka kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Drejtësisë (certifikatë për vërtetim pronësie nr.33, datë 3.7.2008)	Nuk transferohet

VENDIM
Nr.247, datë 31.3.2011

PËR DISA NDRYSHIME DHE NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.51, DATË 26.1.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR NJË SHITESË FONDI KOMITETIT NDËRMINISTROR TË EMERGJENCAVE CIVILE, PËR PËRBALLIMIN E SITUATËS EMERGJENTE TË KRIJUAR NË QARKUN E SHKODRËS SI PASOJË E PËRMBYTJEVE NATYRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.10355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, si dhe të nenit 31 të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.51, datë 26.1.2011 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Miratimin e fondit financiar prej 295 029 876 (dyqind e nëntëdhjetë e pesë milionë e njëzet e nëntë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh, për përballimin e situatës emergjente të krijuar në qarkun e Shkodrës, si pasojë e përmbytjeve natyrore, të ndarë si më poshtë vijon:

a) 270 000 000 (dyqind e shtatëdhjetë milionë) lekë për blerjen, nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të bazës ushqimore (koncentrat e bar i thatë), për periudhën janar-mars 2011;

b) 25 029 876 (njëzet e pesë milionë e njëzet e nëntë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë për kryerjen e punimeve emergjente në disa objekte (argjinatura) për mbrojtjen nga përmbytja.”.

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Fondi prej 295 029 876 (dyqind e nëntëdhjetë e pesë milionë e njëzet e nëntë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet si më poshtë:

a) 125 029 876 (njëqind e njëzet e pesë milionë e njëzet e nëntë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë nga KESH sh.a., për Ministrinë e Brendshme, në programin “Emergjencia civile”;

b) Fondi prej 170 000 000 (njëqind e shtatëdhjetë milionë) lekësh nga buxheti i vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.”.

3. Pas pikës 2 të shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2.1. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nga fondi i mbështetjes për bujqësinë, artikulli 606 “Transferta në buxhetet familjare”, të kryejë rialokimin në artikullin buxhetor 602 të shumës prej 170 000 000 (njëqind e shtatëdhjetë milionë) lekësh, e cila të përdoret nga aparati i ministrisë, për përfundimin e pagesave të detyrimeve, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij vendimi.”.

II. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministri i Brendshëm dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.248, datë 31.3.2011

PËR KALIMIN E SIPËRFAQES 4000 M², PRONË SHTETËRORE, NË FONDIN E KOMPENSIMIT FIZIK DHE KOMPENSIMIN E KOMUNITETIT MYSLIMAN SHQIPTAR, MYFTINIA KORÇË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11/a e 28 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në fondin e kompensimit fizik të truallit, pronë shtetërore, me sipërfaqe 4000 (katër mijë) m², të ndodhur në Korçë, në zonën kadastrale 8563, e përbërë nga prona me numër pasurie 4/41, sipas planit të rivevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi, e cila, në përputhje me ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, vihet në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

2. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pas verifikimit përfundimtar të pronësisë së truallit për fondin e mësipërm, e përdor atë për kompensimin e Komunitetit Mysliman Shqiptar, myftinia Korçë, sipas kriterëve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

3. Ngarkohen Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLAN RILEVIMI

EMËRIME TË NJËRËZORË Nr. 1000 D. 1000 D. 1000	ZONA KATIMORRE INDIKATORI INDEKS - HARTË SHKALLA 1:1000 ADRESA E FASKULETË DIF. KORÇE PIS. Sh. r. 1000 PROGRAMI - Mjetet Mësimore
--	--

- Korruri i zonës së korrur S=5136m² me Vendim të KKP-së Korçe nr. 8, dt 18.01.2007
- Korruri i zonës së korrur S=511m² me Vendim të KKP-së Korçe nr. 8, dt 18.01.2007
- Korruri i zonës së korrur S=2760m² që do të kompensohet sipas procedurave të vlerësimit dhe ekuivalencimit
- Korruri i korrullit që korrkohet për kompensim fizik me S=4000m²
- Vendi i zonës së korrur S=4000m² Korçe
- Korruri i zonës S=1896m² që mbretet pa u kompensuar fizikisht.



VENDIM
Nr.249, datë 31.3.2011

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.10 355, datë 27.11.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për vitin 2011, në programin “Mbështetje për mbikëqyrjen e tregut, infrastrukturën e cilësisë dhe pronësinë industriale”, në zërin “Shpenzime korente”, të shtohet fondi prej 7 000 000 (shtatë milionë) lekësh, i ndarë përkatësisht: 5 000 000 (pesë milionë) lekë për Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë, në zërin “Shpenzime korente” dhe 2 000 000 (dy milionë) lekë për Drejtorinë e Përgjithshme të Markave dhe Patentave, si fond limit në zërin “Shpenzime korente” me burim financimi nga të ardhurat.

2. Kjo shumë të përballohet nga pakësimet e fondeve në programin “Mbështetje për burimet natyrore”, nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, në zërin “Shpenzime për pagat” me burim financimi nga të ardhurat.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e udhëzimit të përbashkët për përdorimin e të ardhurave që siguron Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave, sipas vendimit nr.883, datë 13.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tarifave, për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.250, datë 31.3.2011

**PËR PROPOZIMIN, KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË
KANDIDATURAVE ALTERNATIVE PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË SHËRBBIMIT
CIVIL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 2 e 7, pika 2 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Propozimin, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të kandidaturave alternative për anëtar të Komisionit të Shërbimit Civil, si më poshtë vijon:

- Z. Afred Prifti;
- Z. Gentian Opre;
- Z. Endrit Lami.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.251, datë 31.3.2011

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË DIBRËS

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës, dhe të nenit 4 të ligjit nr.8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Xhafer Seiti, prefekt i qarkut të Dibrës, lirohet nga kjo detyrë.
 2. Z. Genc Sharku emërohet prefekt i qarkut të Dibrës.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.252, datë 9.2.2011

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.793, DATË 24.9.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.10 142, DATË 15.5.2009 “PËR SIGURIMIN SHOQËROR SUPLEMENTAR TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, TË GARDËS SË REPUBLIKËS, TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT, TË POLICISË SË BURGJEVE, TË POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE TË SHPËTIMIT E TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 4, 5 pika 1, 11, 22, 23, pika 1, 26 e 29 të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.793, datë 24.9.2010 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kreun I “Vjetërsia në shërbim”, shkronja “A”, pika 15, pas fjalëve “... Koha e plotë e vuajtjes së dënimit me burgim...” shtohen fjalët “... ose internim...”.

2. Në kreun II “Paga referuese”, pas shkronjës “DH” shtohet shkronja “E”, me këtë përmbajtje:

“E. Paga mesatare referuese, e përcaktuar dhe e llogaritur sipas shkronjave “a” deri në “dh” të këtij kreu, kthehet në pagë mesatare referuese neto, pas zbritjes së shumës së kontributit të detyrueshëm të sigurimit shoqëror; kontributit të detyrueshëm të sigurimit shëndetësor; tatimit mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimit suplementar, që mbahen nga paga, sipas përcaktimeve të bëra në legjislationin në fuqi, në kohën kur personit i ka lindur e drejta për përfitim. Paga mesatare referuese neto evidentohet sipas formularit bashkëlidhur.”

3. Në kreun III “Procedurat e përfitimeve dhe dokumentacioni”, bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 1, të shkronjës “C”, nëndarja e parë, pas fjalëve “...dhe pagën referuese...” shtohet fjala “...neto...”, kurse nëndarja e tretë, “Dëshmi penaliteti”, shfuqizohet.

b) Në pikën 4, të shkronjës “D”, pas fjalëve “...Ministria e Mbrojtjes...” të shtohen fjalët “...komanda e forcave, komanda e doktrinës dhe stërvitjes, brigada, regjimenti, reparti ose njësia në varësi të drejtpërdrejtë të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe institucioni në varësi të drejtpërdrejtë të Ministrisë së Mbrojtjes...”.

c) Në shkronjën “D” të shtohet pika “5”, me këtë përmbajtje:

“5. Ministri i Mbrojtjes dërgon në Institutin e Sigurimeve Shoqërore listën e strukturave që do të përgatitin këto dokumentacione dhe do të plotësojnë formularët përkatës.”.

ç) Shkronja “E” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“E. Masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi dhe e pensionit suplementar, për rastet kur vjetërsia e shërbimit njihet me 1.5-fish, llogaritet në bazë të periudhës së rivlerësuar të shërbimit dhe të pagës referuese, të llogaritur sipas përcaktimeve të bëra në kreun II, shkronja “DH”, të këtij vendimi.”.

d) Shkronja “Ë” shfuqizohet.

4. Në kreun V “Rillogaritja e përfitimeve”, bëhen këto ndryshime:

a) Pikat 1 dhe 2 të shkronjës “C”, ndryshohen si më poshtë vijon:

“1. Masa fillestare e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të caktuar do të rillogaritet sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 1 të nenit 14 të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009, të ndryshuar, dhe, pas këtij veprimi, kur masa mujore e përfitimit, në momentin e lindjes së të drejtës, është më e vogël se pensioni bazë, sipas nenit 32 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendoset sa pensioni bazë i pleqërisë. Mbi këtë masë përfitimi zbatohen koeficientët e rritjes apo të indeksimit të pensionit, të zbatuar për pensionet e pleqërisë në përputhje me nenin 32 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të përcaktuara me vendime të Këshillit të Ministrave, deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit të sipërpërmendur, dhe shuma që del vlerësohet si shumë përfundimtare e pensionit.

2. Për efekt të rillogaritjes së masës fillestare të pensionit të parakohshëm, data, mbi të cilën do të referohet pagë mujore mesatare referuese neto, do të jetë:

a) data 1 janar 1999 (data e shtrirjes së efekteve financiare të ligjit nr.8087, të ndryshuar) për ata persona, të cilët kanë dalë në rezervë/lirim para kësaj date dhe kanë përfituar pension të parakohshëm nga kjo datë e në vazhdim;

b) data kur ka lindur e drejta për të përfituar pension të parakohshëm, për ata persona, të cilët kanë dalë në rezervë/lirim para datës 1 janar 1999, por kanë plotësuar kushtin e moshës pas kësaj date;

c) data kur ka lindur e drejta për të përfituar pension të parakohshëm, për ata persona, të cilët kanë dalë në rezervë/lirim pas datës 1 janar 1999.”.

b) Pika 1 e shkronjës “D” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Masa fillestare e pensionit suplementar të caktuar do të rillogaritet sipas kriterëve të përcaktuara në nenet 16, 18 dhe 20 të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009, të ndryshuar, në përputhje me llojin e së drejtës dhe, më pas, mbi këtë masë përfitimi, zbatohen koeficientët e rritjes apo të indeksimit të pensionit, të zbatuar për pensionet e pleqërisë në përputhje me nenin 32 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të përcaktuara me vendime të Këshillit të Ministrave, deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit të sipërpërmendur, dhe shuma që del vlerësohet si shumë përfundimtare e pensionit.”.

5. Në kreun VI “Efektet financiare”, bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja “C” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“C.1. Personat që përfitojnë pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas nenit 14 të ligjit, të ndryshuar (përfshirë të punësuarit që përfitojnë njëkohësisht dhe pension të parakohshëm), përfitojnë kompensim, në masën 350 (treqind e pesëdhjetë) lekë në muaj, në përputhje me vendimin nr.138, datë 31.3.1994 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”, dhe kompensim, në masën 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë në muaj, në përputhje me vendimin nr.471, datë 15.7.1996

të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin e shpenzimeve nga liberalizimi i çmimit të bukës, lëndëve djegëse dhe vajgurit.”.

2. Personat, që përfitojnë pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas nenit 14, të ligjit, të ndryshuar, kur janë kryefamiljarë dhe kanë të ardhura familjare vetëm nga pensioni i parakohshëm, përfitojnë kompensim, në masën 640 (gjashtëqind e dyzet) lekë në muaj, në përputhje me kushtet e përcaktuara në vendimin nr.565, datë 9.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”, të ndryshuar.

3. Kur personat që përfitojnë pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, në çastin e lindjes së të drejtës dhe pas shtesës së kompensimeve, sipas pikës 1, të këtij vendimi, kanë të ardhura mujore, më pak se të ardhurat minimale mujore, të përcaktuara për pensionet e plota të pleqërisë, të caktuara sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ardhurat e tyre kompensohen, deri në nivelin e të ardhurave minimale, të përcaktuara për pensionet e pleqërisë.”.

b) Pas shkronjës “C” shtohet shkronja “D”, me këtë përmbajtje:

“D. Kur shuma e pensionit të parakohshëm, të rillogaritur sipas dispozitave të ligjit nr. 10 142, datë 15.5.2009, të ndryshuar, rezulton në shtesë mbi shumat e përfituara më parë në një masë më të madhe se shuma e të ardhurave individuale vjetore nga pensioni, pagesa bëhet me këste. Madhësia e këstit vjetor do të jetë deri në shumën e të ardhurave nga pensioni aktual për një vit. Fondet për pagesën e diferencave të pensioneve programohen në buxhetin vjetor.”.

II. Ngarkohen Ministria e Financave, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe ministritë e institucionet përgjegjëse, që, brenda tre muajve nga dalja e këtij vendimi, të nxjerrin udhëzimet përkatëse dhe të marrin masat për plotësimin e dokumentacionit për karrierën, pagën mesatare e referuese etj.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.7.2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Nr.....Prot

Tirane me _____

**VERTETIM
 PER**

VJETERSINE NE SHERBIM DHE PAGEN MESATARE NETO REFERUESE

Emri		Date lindje
Atesia		Vendlindje
Mbiemri		Vend Banimi
Nr.kartes se identitetit		

I		TITULLIMI FILLESTAR							
1	Organi a Reparti qe ka bere titullin								
2	Titulli qe ka fituar (Oficer, nenoficer, polic ushtar, rrogetar)								
3	Urdheri i titullimit, numer, date								
II		DALJA NE REZERVE OSE NE LIRIM							
1	Organi a Reparti ku eshte realizuar dalja ne rezerve, lirim								
2	Urdheri per daljen ne rezerve, lirim (numri, data)								
3	Funksioni Organik ne momentin e daljes ne rezerve, lirim								
4	Grada ushtarake ne momentin e daljes ne rezerve, lirim								
5	Data e nderprerjes se marredhenieve financiare me organin e repartit								
6	Motivacioni i daljes ne rezerverezerve								
		Koha e karrieres		Paga referuese ne momentin e lindjes te se drejtes					
Nr	Funksionet ose gradat gjate karrieres	Fillimi	Perfundimi	Paga baze per grade sipas viteve te sherbimit	Shtesa per kushte te vecanta sherbimi	Shtesa per pune te veshtire dhe te demshme per shendetin	Shuma e pages bruto(e+f+g)	Paga neto	
a	b	c	d	e	f	g	h	j	
1	Periudha e karrieres neni 3 pika 1								
2									
3									
4									
5									
6									
7									
8									
	Shuma								
II	Neni 3 pika 4 germa a (Nderprerje)								
III	Neni 3 pika 4 germa b (denimi politik)								
	Shuma (I+II+III)								
	Paga mesatare referuese								
IV	Neni 3 pika 5 (1.5 fish)	Fillimi	Mbarimi						

PERGJEGJES PER PERSONELIN ZBATUES

NENPUNES

Komandanti/Drejtuessi i Njesise

VENDIM
Nr.253, datë 31.3.2011

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.574, DATË 28.5.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME PUBLIKE, SHETËTËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË
PËRDORIM TË BASHKISË FIER TË QARKUT TË FIERIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike, të shtetit, në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.574, datë 28.5.2009 të Këshillit të Ministrave, të shtohen pronat, sipas lidhjes nr.1 dhe formularëve që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Fier

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
851, 847	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
596 (vetëm pasuritë 1/1095,1/990,1/631,1/597,1/614.1/617), 848,849,850	Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike), rrugë vendore	Në pronësi
843, 844,845	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi

VENDIM
Nr.254, datë 6.4.2011

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.478, DATË 18.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1, të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të shkronjës “b”, të pikës 1, të vendimit nr.478, datë 18.7.2007, të ndryshuar, të shtohen emërtesat “Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” dhe “Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit”.

2. Punonjësit mbështetës të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit të paguhen sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore.

3. Efektet financiare për shtesën për kushte pune, për titullarin dhe administratorët në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, përcaktuar sipas vendimit nr.179, datë 2.2.2011 të Këshillit të Ministrave, të fillojnë nga data 1 janar 2011.

4. Efektet financiare të këtij vendimi, për vitin 2011, të përballohen nga fondet e miratuara tashmë për vitin 2011, të këtyre institucioneve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.255, datë 2.4.2011

PËR SHPALLJE DITË ZIJE KOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr.8926, datë 22.7.2002 “Për formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, përmbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e stemës së Republikës së Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre”, si dhe të pikës 8 kreu VI të vendimit nr.229, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen ditë zije kombëtare, ditën e hënë datë 4.4.2011, në nderim të udhëheqësit shpirtëror të bektashizmit shqiptar dhe botëror Kryegjyshit Botëror Haxhi Dede Reshat Bardhi.

2. Në të gjitha institucionet shtetërore dhe publike të ulet flamuri kombëtar në gjysmështizë dhe, në orën 12:00, të mbahet një minutë heshtje.

3. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të ndjekë organizimin e ceremonialit dhe të përballojë shpenzimet e varrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.293, datë 14.4.2011

**PËR KOMPENSIMIN E VLERËS SË TAKSËS SË BIZNESIT TË VOGËL, TË PËRDORUR
PËR RIMBURSIMIN E PAJISJEVE FISKALE DHE TAKSIMETRAVE PËR 7 KOMUNA
DHE 3 BASHKI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e vlerës së pajisjeve fiskale dhe taksimetrave, njësite të qeverisjes vendore, 7 komuna dhe 3 bashki, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ky fond, në vlerën 237 114 774 (dyqind e tridhjetë e shtatë milionë e njëqind e katërmbëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë, të përballohet nga fondi i kontingjencës.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Nr.	Emri i NJQV-së	Vlera (lekë)
1	Bashkia Gjirokastrë	13,200,000
2	Bashkia Libohovë (Gjirokastrë)	729,140
3	Komuna Dropull i Poshtëm (Gjirokastrë)	2,714,000
4	Komuna Dropull i Sipërm (Gjirokastrë)	1,628,000
5	Komuna Lunxhëri	396,000
6	Komuna Melan (Dibër)	176,000
7	Bashkia Tiranë (pjesa II)	216,763,034
8	Komuna Xarrë (Sarandë)	700,600
9	Komuna Shushicë (Vlorë)	176,000
10	Komuna Kajan (Elbasan)	632,000
	Shuma	237,114,774

UDHËZIM

Nr.14, datë 28.3.2011

PËR NJOHJEN E TESTIMEVE DHE CERTIFIKIMEVE PËR GJUHËN ANGLEZE PËR PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË DHE TË TRETË NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Përcaktimin e listës së testeve të gjuhës angleze të njohura ndërkombëtarisht¹ (shih shtojcën 1), si kërkesë për përfundimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë të ofruara në institucionet e arsimit të lartë.

2. Klasifikimi i aftësive gjuhësore dhe niveleve të kompetencave gjuhësore sipas Kuadrit të

¹ Njohje ndërkombëtare-nënkupton referencën që testi gjuhësor gëzon ndaj niveleve gjuhësore të përcaktuara sipas kuadrit gjuhësor të nënshkruar nga një vend. Në shtojcën 1 të këtij udhëzimi janë përfshirë testet që kanë referencë ndaj niveleve gjuhësore të përcaktuara sipas: i) Kuadrit të Përbashkët European të Referencave për Gjuhët (KPERGJ) (Common European Framework of References for Languages (CEFR); ii) Shoqatës së Testuesve të Gjuhës në Europë – Association of Language Testers in Europe (ALTE) dhe iii) Kuadrit European të Kualifikimeve (KEK) European Qualification Framework (EQF).

Përbashkët European të Referencave për Gjuhët (KPERGJ) (shih shtojcën 2), shërben si standard në Republikën e Shqipërisë për gjuhët e huaja dhe testet gjuhësore.

3. Njohjen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) të testeve ndërkombëtare të gjuhës angleze të përcaktuara në shtojcën 1, të cilat:

a) zhvillohen në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj;
b) kryhen nga subjekte, të cilat janë të certifikuara nga qendrat/organizatat që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale mbi testet dhe të drejtën e certifikimit bazuar në modalitetet e vendosura për zhvillimin e testeve ndërkombëtare të përcaktuara në shtojcën 1.

4. Përcaktimin e nivelit minimal të pranueshëm të kompetencës gjuhësore, si më poshtë vijon:

a) Niveli B2 (kompetencë operative e mjaftueshme gjuhësore) për programet e ciklit të dytë “Master Profesional”;

b) Niveli C1 (kompetencë operative e kënaqshme gjuhësore) për programet e ciklit të dytë “Master i Shkencave” dhe për studimet e ciklit të tretë.

Institucionet e arsimit të lartë kanë të drejtë të përcaktojnë nivele të zotërimit të gjuhës angleze më të larta se ato minimale të përshkruara në pikat 4.a dhe 4.b të këtij udhëzimi.

5. Institucionet e arsimit të lartë të shpallin:

a) listën e testeve të gjuhës angleze sipas shtojcës 1 (pjesë e këtij udhëzimi) dhe vlefshmërinë e tyre kohore;

b) nivelet e kompetencës gjuhësore përkatëse për programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë sipas pikës 4 të këtij udhëzimi;

c) subjektet e parashikuara në pikën 3 të këtij udhëzimi, me të cilat institucioni i arsimit të lartë ka nënshkruar marrëveshje të veçanta bashkëpunimi për ofrimin e testimit për studentët (nëse ka).

6. Institucionet e arsimit të lartë të përcaktojnë në statutet dhe në rregulloret e studimeve procedurat dhe modalitetet e dhënies së provimit të gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare dhe niveleve të kompetencës gjuhësore të përcaktuar në këtë udhëzim.

7. Qendrat/organizatat që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale mbi testet dhe të drejtën e certifikimit lidhin marrëveshje me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës me qëllim shkëmbimin e informacionit në lidhje me testimin e gjuhës angleze të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë.

8. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

SHTOJCA 1

Lista e testeve të gjuhës angleze, të njohura ndërkombëtarisht, në zbatim të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar:

- Cambridge ESOL – University of Cambridge Examinations;
- IELTS – International English Language Testing System;
- TOEFL – Test of English as a Foreign Language;
- TOEIC – Test of English for International Communication;
- Michigan – Test;
- PTE General – Pearson Test of English General.

SHTOJCA 2
PËRSHKRIMI I NIVELEVE GJUHËSORE SIPAS KUADRIT TË PËRBASHKËT
EUROPIAN TË REFERENCAVE PËR GJUHËT (KPERGJ)

Niveli	Përshkrimi i përgjithshëm i niveleve gjuhësore
A1	Mund të kuptojë dhe të përdorë shprehje të përditshme dhe shprehje bazë që synojnë plotësimin e nevojave konkrete. Mund të prezantojë veten dhe të tjerët dhe të pyesë e të përgjigjet për detaje vetjake, si: ku jeton, banon, njerëzit që njeh, sendet që ka etj. Mund të komunikojë në një mënyrë të thjeshtë nëse bashkëbiseduesi flet ngadalë, qartë dhe është i gatshëm ta ndihmojë.
A2	Mund të kuptojë fjali dhe shprehje të përditshme që lidhen me fusha të nevojës më të domosdoshme, si p.sh.: informacion bazë rreth tij dhe familjes, në dyqan, gjeografi lokale, punëve që bën. Mund të komunikojë për detyra të thjeshta dhe rutinë që kërkojnë shkëmbim informacioni të drejtpërdrejtë për çështje të njohura dhe të përditshme. Mund të përshkruajë me terma të thjeshtë aspekte të formimit të tij/saj, mjedisit rrethues dhe çështje të fushave me interes të drejtpërdrejtë.
B1	Mund të kuptojë çështjet kryesore të njohura që hasen rregullisht në shkollë, punë, argëtim etj. Mund të merret vesh (është i aftë të orientohet) në situata të ndryshme gjatë një udhëtimi në vende ku flitet gjuha në fjalë. Mund të hartojë materiale të thjeshta për tema të njohura ose të një fushe të interesit personal. Mund të përshkruajë përvoja dhe ngjarje, ëndrra, shpresa dhe ambicie, si dhe të arsyetojë e shpjegojë në mënyrë të përmbledhur mbi opinione dhe plane të ndryshme..
B2	Mund të kuptojë idetë kryesore të një teksti kompleks mbi çështje konkrete dhe abstrakte, duke përfshirë diskutime teknike në fushën e tij/saj të specializimit. Mund të bashkëveprojë rrjedhshëm dhe spontanisht, me folës vendas pa vështirësi për të dyja palët. Mund të hartojë tekst të qartë, të detajuar rreth një sërë temash, si dhe të shpjegojë pikëpamjet e tij/saj për një çështje të ditës, duke parashtruar avantazhet dhe disavantazhet për opsione të ndryshme.
C1	Mund të kuptojë tekste më të gjata me një shkallë më të gjerë kërkesash dhe të kuptojë thënie të tërthorta. Mund të shprehet rrjedhshëm dhe spontanisht. Mund ta përdorë gjuhën në mënyrë elastike dhe efektive për qëllime akademike sociale dhe profesionale. Mund të hartojë tekst të qartë, të mirëstrukturuar, të detajuar për tematika komplekse, duke mundësuar përdorim të qartë të organizimit të të menduarit dhe të të shprehurit.
C2	Mund të kuptojë lehtësisht çdo gjë që dëgjon apo lexon. Mund të përmbledhë informacionin e marrë nga burime të ndryshme të shkruara ose të dëgjuara, duke riformuluar argumentet dhe rezultatet në një prezantim koherent. Mund të shprehet spontanisht, shumë rrjedhshëm dhe saktë, duke dalluar nuancat kuptimore edhe në situatat më komplekse.

KËRKESE

Kërkuesja Mero Gazidedja, e bija e Hekuranit dhe e Pajames, e datëlindjes 9.4.1954 lindur në Ad-Bunac, Fier dhe banuese në Fier, kërkon shpalljen të zhdukur të bashkëshortit të saj, shtetasit Nazmi Gazidedja, i datëlindjes 6.8.1946.

KËRKUESJA
Mero Gazidedja

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 28.4.2011
Doli nga shtypi më 29.4.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 40 lekë